

VENDIM
Nr.890, datë 21.12.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 400 KV
TIRANË 2 - ELBASAN 2, QARKU TIRANË, KOMUNAT VAQAR, KËRRABË DHE
PETRELË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kV Tiranë 2 - Elbasan 2, qarku Tiranë, komunat Vaqar, Kërrabë dhe Petrelë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të OST sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme të shpronësimit prej 241 (dyqind e dyzet e një) m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 3 623 400.00 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e tri mijë e katërqind) lekësh.

4. Fondi prej 3 623 400.00 (tri milionë e gjashtëqind e njëzet e tri mijë e katërqind) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit dhjetor 2011 dhe të përfundojë brenda muajit mars 2012.

6. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OST sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha